



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr- 410 4535

Më datë 20.01.2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58, të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 30 dhe 45, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 16, i Ligjit Nr. 04/L-174, për Planifikim Hapësinor, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013” dhe nenit 44, lidhur me nenin 49, të Ligjit Nr. 05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-20/2016” Kryetari i Komunës së Suharekës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Ekipit Komunal për Planifikim të HZK-së

1. Me qëllim të ofrimit të vizionit, qëllimit dhe objektivave në procesin e planifikimit të Hartës Zonale të Komunës, e që duhet të definojnë në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe palët e interesit, formohet Ekipi Komunal i Planifikimit të Hartës Zonale Komunës (në tekstin e metjem HZK) në këtë përbërje:
 - 1.1 Visar KUÇI, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim,
 - 1.2 Destan BERISHA, Menaxher i projektit,
 - 1.3 Nexhmije LOSHI-DURMISHI, koordinatore i projektit,
 - 1.4 Isuf HAJDARI, Drejtoria për Shërbime Publike, Mjedis dhe Emergjencë,
 - 1.5 Shaqir MALA, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
 - 1.6 Shkelqim SALIHU, Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër,
 - 1.7 Kymete BAJRAKTARI, Drejtoria për Administratë,
 - 1.8 Adem KADOLLI, Drejtoria për Inspektion,
 - 1.9 Agim BYLYKBASHI, Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet,
 - 1.10 Xhemajli ALIU, Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari,
 - 1.11 Sahadete LUMI-KUQI, Drejtoria për Arsim,
 - 1.12 Refki GOLLOPANI, Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë dhe
 - 1.13 Avni BYTYÇI, Shef i shërbimit të Kuvendit dhe zyrtar ligjor.
2. Udhëheqëse i Ekipit Komunal për Planifikim të HZK-së, sipas detyrës zyrtare, emërohet z. **Visar KUÇI**
3. Koordinatore i Ekipit Komunal për Planifikim të HZK-së, për koordinimin e punëve të Ekipit Komunal për Planifikim të HZK-së dhe të kompanisë “INSI” Sh.P.K me seli në Prishtinë, është znj. **Nexhmije LOSHI-DURMISHI**
4. Detyra e Ekipit Komunal për Planifikim (EKP) është të punojnë në hartimin e HZK-së, në bashkëpunim me kompaninë “INSI” Sh.P.K me seli në Prishtinë, konform Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-30/2013” dhe në mbështetje të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.24/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

5. Anëtarët e EKP-së obligohen që të ofrojnë përkrahjen e tyre profesionale dhe intelektuale nga fushë-veprimtaria e drejtorisë përkatëse. Në moment kur kërkohen informata dhe propozime profesionale nga lëmi që ofron drejtoria përkatëse, anëtari përfaqësues i drejtorisë mund të kërkojë nga zyrtarët kompetent brenda drejtorisë por edhe jashtë saj siç janë: intelektualë, ekspertet të pavarur, shoqata të ndryshme e të ngjashme (në këto raste duhet të mbahet evidenca e ofruesit të informatës respektivisht idesë dhe propozimit në dosje).
6. EKP-ja obligohet të bashkëpunoi me të gjitha institucionet, shoqatat, grupet e interesit, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend të Komunës e të ngjashme, në kuptim të gjithëpërfshirës dhe rritjes së cilësisë së hartës zonale të Komunës.
7. Harta Zonale e Komunës duhet të përfundojë, me të gjitha procedurat, brenda vitit kalendarik 2022.
8. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe e shfuqizon vendimin me numër të protokollit 01-Nr-016-78329 të datës 26.11.2019.
9. Ndërsa mandati i EKP përfundon me miratimin të HZK-së nga Kuvendi të Komunës në Suharekë.


Kryetari i Komunës
Bali MUHARRREMAJ

I dorëzohet:
DUP-së
Anëtarëve të ekipit,
Në dosje,